

VENDIM
Nr. 1092, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË
ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE NË ZONËN E SEMANIT,
NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA
SHOQËRIA “GREENTECH” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “Greentech” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: “Greentech” sh.p.k.;
- b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L92924402E;
- c) Tipi i centralit: eolik;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 3 mw;
- d) Numri i njësive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapaciteti i tyre në mw: 1 (një) turbinë me kapacitet 3 mw;
- dh) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;
- e) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: zona e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier;
- ë) Afati i miratimit të ndërtimit: 48 (dyzet e tetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;
- f) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi;
- g) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuar prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synimin që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit e të dokumentacionit të projektit;
- gj) Shoqëria “Greentech” sh.p.k., ka detyrimin:
 - i. që të paraqesë periodikisht (çdo 3 (tre) muaj), pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;
 - ii. që të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. e dorëzimit të sigurimit të kontratës, në masën jo më pak se 5 (pesë) % të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “Greentech” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat e detyrimit e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv. që t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, “Greentech” sh.p.k., duhet t’i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;
 - v. që të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI 1

Koordinatat e tokës

Shoqëria “Greentech”, sh.p.k., është pajisur me kontratë “Për dhënien me qira të tokës ranishte” nr.1617 Rep., nr. 596 Kol, datë 23.12.2019, ndërmjet Bashkisë Fier dhe “Greentech”, sh.p.k. Objekt i kësaj kontrate është marrja me qira e një pasurie shtetërore të paluajtshme e llojit tokë pa frut (ranishte), me sipërfaqe 37,300 m², e ndodhur në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, me numër pasurie 286/6, zona kadastrale 3358, volum 10, faqe 86, e regjistruar në ZVRPP Fier me certifikatë pronësie, lëshuar më 6.2.2019.

X	Y
363446.53	4517253.923
363926.088	4517253.923
363446.53	4516857.048
363926.088	4516857.048

